



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 1714

NR. VENDIMI 1517



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Nr. 1714 Regj.Themeltar
Datë Regjistrimi 12.03.2021

Nr. 1517 Vendimi
Datë 26.05.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtar: SOKOL PASHO

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Besarda Allaraj**, sot më datë 22.01.2020, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me **Nr. 1714** Akti, që i përket:

KËRKUES:
Tiranë

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

I PANDEHUR:

*** identifikuar me karte idenriteti me nr. ***i biri i *** dhe i *** i dtl. *** lindur dhe banues ne *** banese private, arsim i larte, beqar, i padenuar, me shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga avokat Z. *** me nr. *** Liçense dhe Nipt ***

*** identifikuar me karte identiteti me nr. *** , i biri i *** dhe i *** i dtl. ***lindur dhe banues ne *** nr. 59, arsim i larte, beqar, i padenuar, me shtetesi shqiptare.

***identifikuar me karte idenriteti me nr. *** i biri i *** dhe i *** i dtl. ***lindur ne *** dhe banues ne *** , arsim i larte, beqar, i padenuar, me shtetesi shqiptare -ne mungese-, mbrojtur ne gjykim nga avokat Z. ***me nr. ***Liçense dhe Nipt ***.

AKUZUAR:

Për veprën penale “Fshehje e të ardhurave” dhe “Shkelja e të

drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 180/1 dhe 149/a/2 i K.Penal.

VIKTIMA:

Shoqëria ***. me përfaqësues Z. ***. (në mungesë)

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, mori e administroi provat e nevojshme, dëgjoi përfundimisht palët që kërkuan:

Prokurori *:**

- Deklarimin fajtor të pandehurit: ***, për veprën penale të "Shkeljes së drejtave të pronësisë industriale" parashikuar nga nenet 149/a/2 dhe denimin e tij me *** muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit ***, për veprën penale të "Fshehje të ardhura" parashikuar nga neni 180/1 i K.Penal dhe denimin e tij me *** muaj burgim
- Në bazë të nenit 55 të K.Penal, për "caktimin e denimeve për disa vepra penale", denimin e pandehurit *** me *** muaj burgim
- Deklarimin fajtor të pandehurit ***, për veprën penale të "Shkeljes së drejtave të pronësisë industriale" parashikuar nga nenet 149/a/2 dhe denimin e tij me *** muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit ***, për veprën penale të "Fshehje të ardhura" parashikuar nga neni 180/1 i K.Penal dhe denimin e tij me *** muaj burgim.
- Në bazë të nenit 55 të K.Penal, për "caktimin e denimeve për disa vepra penale", denimin e pandehurit *** me *** muaj burgim
- Deklarimin fajtor të pandehurit ***, për veprën penale të "Shkeljes së drejtave të pronësisë industriale" parashikuar nga nenet 149/a/2 dhe denimin e tij me *** muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të pandehurit ***, për veprën penale të "Fshehje të ardhura" parashikuar nga neni 180/1 i K.Penal dhe denimin e tij me *** muaj burgim.
- Në bazë të nenit 55 të K.Penal, për "caktimin e denimeve për disa vepra penale", denimin e pandehurit *** me *** muaj burgim
- I sugjerojmë Gjykatës aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale "Për gjykimin e shkurtuar"
- Në bazë të nenit 59, 60 të K.Penal, pezulimin e ekzekutimit, për një periudhë kohe *** muaj, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepra tjeter penale po aq të rënda apo më të rënda dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar
- Shpenzimet gjyqësore në fazën e hetimit të ngarkohen të pandehurit

Mbrojtësi i të pandehurit *, avokati ***:**

Lidhur me nenin 180/1 i K.Penal mendojmë se nuk ka veprën penale, nuk plotësohen elementët e kësaj vepre. Gjithësesi, nëse gjykata e gjen fajtor të mbrojturin prej

meje, atëherë në lidhje me caktimin dhe llojin e dënimit, kërkojmë aplikimin e nenit 63 të K.Penal, duke e detyruar të pandehurin që të kryejë orë pune në komunitet

Mbrojtësi i të pandehurit *, avokati ***:**

- Lidhur me nenin 180/1 i K.Penal mendojmë se nuk ka vepër penale, nuk plotësohen elementët e kësaj vepre. Gjithësesi, nëse gjykata e gjen fajtor të mbrojturin prej meje, atëherë në lidhje me caktimin dhe llojin e dënimit, kërkojmë aplikimin e nenit 63 të K.Penal, duke e detyruar të pandehurin që të kryejë orë pune në komunitet

I pandehuri *:**

- Lidhur me nenin 180/1 i K.Penal mendojmë se nuk ka vepër penale, nuk plotësohen elementët e kësaj vepre. Gjithësesi, nëse gjykata më gjen fajtor, atëherë në lidhje me caktimin dhe llojin e dënimit, kërkoj aplikimin e nenit 63 të K.Penal.

V Ë R E N:

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ana e organit të akuzës është paraqitur kërkesa për gjykim kundër të pandehurve ***, *** dhe ***, të akuzuar për veprat penale “Fshehja e të ardhurave” dhe “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuara nga neni 180/1 dhe 149/a/2 i Kodit Penal.

Nga aktet e seancës paraprake rezulton se të pandehurit dhe mbrojtësit kanë kërkuar gjykim të shkurtuar, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjëndjen që janë aktet në fashikullin e Prokurorisë të sjellë për gjykim. Në këto kushte, Gjykata bazuar në nenin 405 të K.Pr.Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të proçedojë me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjëndjen që janë paraqitur aktet nga Organi i Prokurorisë, pasi nga palët nuk pati pretendime pavlefshmërie, papërdoshmërie, për aktet si dhe të tjera kërkesa paraprake të kësaj natyre.

Gjykata, në respektim të dispozitave ligjore (*nenit 405 të K.Pr.Penale*), duke vlerësuar se aktet janë të plota dhe se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen në të cilat ndodhen këto akte, vendosi zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke pranuar kërkesën e bërë nga të pandehurit dhe mbrojtësit.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen konkluzionet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit referues të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, ka regjistruar proçedimin penal nr. ***, datë ***, për veprat

penale “Fshehja e të ardhurave” dhe “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuara nga neni 180/1 dhe 149/a/2i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve ***, ***, dhe ***.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes rezultoi e provuar se, shërbimet e policisë gjyqësore, prej disa muajsh janë venë në dëni nga kompania “****” për disa akte të piraterisë televizive nga individë pa asnjë lloj liçensimi, të cilët vjedhin programe të kompanisë “****”, e cila nga veprime të tilla pëson dëm ekonomik si dhe dëm në imazhin e saj.

Nga hetimet ka rezultuar se shtetasi *** i cili operon në Tiranë, ka të hapur një llogari në Bankën ***, ku individë të ndryshëm derdhen në llogari të tij, shuma të caktuara për shitje programesh televizive.

Gjithashtu edhe shtetasit *** në datën 02.06.2020, i janë gjetur dhe sekuestruar në makinë dy aparate *** me programe të instaluar, të cilat ky shtetas tentonte ti tregtonte. Gjithashtu në banesën e tij janë gjetur edhe dy njësi kompjuterike ***, të cilat dyshohen se janë përdorur për instalimin e këtyre programeve.

Për sa i përket të pandehurit ***, edhe këtij shtetasi i janë gjetur paisje të *** me programe të instaluar të ***, ku përveç sa sipër edhe në aparatin e tij të telefonit celular, janë konstatuar komunikime të tij me shumë persona për shitjen e aparaturave për transmetimin e programeve të ***.

Në funksion të parashtrimeve të mësipërme, nga ana e tij organi i akuzës faktet e mësipërme i provon me :

- Proces verbalin e kallëzimit të paraqitur nga Kompania ***, ku parashtrihet sa sipër,
- Aktet e komunikimeve me Bankat e nivelit të dytë;
- Proces verbalet e arrestimit të të pandehurve;
- Proces verbal i kontrollit të subjektit ***.
- Proces verbal kqyrje telefoni celular;
- Deklarimet e shtetasve ***, ***, ***, ***, etj

Mbi bazën e këtyre fakteve nga akuza u kërkua deklarimi fajtor i të të pandehurve ***, *** dhe ***, për kryerjen e veprat penale “Fshehja e të ardhurave” dhe “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuara nga neni 180/1 dhe 149/a/2i Kodit Penal dhe dënimi i tyre, në masën e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke parashtruar se me veprimet e tij të kryera me dashje, i pandehuri ka konsumuar elementet e vepres penale të parashikuara nga neni 180/1 dhe 149/a/2 të Kodit Penal.

Arsyetimi i Gjykates, argumentat juridike, interpretimi i dispozitave penale, analiza e provave.

E ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, përcaktimit të faktit dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se veprimet e të të pandehurve ***, *** dhe ***, plotësojnë të gjitha elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuara nga neni 149/a/2 i Kodit Penal.

Në përmbajtjen e nenit 149/a të K.Penal, sanksionohet se:

“Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i:

- a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës;*
- b) produktit që mbrohet nga një dizenjo industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjosit industriale;*
- c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare;*
- ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik; të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.*

Po kjo veprë kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Në përfundim, në analizë të akteve shkresore provuese të administruara në gjykim, në interpretim të kuadrit ligjor material penal i cili parashikon veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë (Kreu III Seksioni II i Kodit Penal) Gjykata krijon bindjen e plotë se, nga ana e të pandehurve ***, ***, dhe ***, janë konsumuar tërësisht elementët e figurës së veprës penale “Shkelja e të drejtave të Pronësisë industriale”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 149/a/2 i Kodit Penal dhe ata duhet të deklarohen fajtorë për sa akuzohen.

Fajësia e të pandehurve ***, ***, dhe ***, si autorë të veprës penale për të cilën akuzohen, u provua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm me provat e cituara si me sipër dhe në tërësi me aktet shkresore provuese të paraqitura nga ana e organit të akuzës, pjesë e fashikullit penal rr. ***, të vitit ***,.

Përsa i përket kualifikimit ligjor të fakteve objekt akuze, të parashtruara më lart, Gjykata vëren se, neni 149/a i K.Penal parashikon: “Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i: a) produktit ose procesit të mbrojtur nga një patentë, pa pëlqimin e pronarit të patentës; b) produktit që mbrohet nga një dizenjo industriale, pa pëlqimin e pronarit të dizenjosit industriale; c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare; ç) produktit që rrjedh nga një tregues gjeografik, pa pëlqimin e pronarit të treguesit gjeografik; të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Po kjo veprë kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

Konkretisht përsa i përket objektit të figurës së veprës penale për të cilën akuzohen, të pandehurit ***, ***, dhe ***, me veprimet e tyre të kundërligjshme kanë cënuar ato marrëdhënie juridike të vendosura me ligj për të garantuar, mbarëvajtjen e ekonomisë dhe qarkullimit civil në përgjithësi, marrëdhënie këto të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni material penal. Nga ana objektive, rezulton të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm nga aktet shkresore provuese të përfshira në fashikujt e hetimeve paraprake se, të pandehurit ***, ***, dhe ***, e kanë kryer veprën penale me veprime të kundërligjshme që konsistojnë në, përdorimin pa të drejtë të një marke të mbrojtur, e cila i përket subjektit të dëmtuar, viktimë

për efekt të këtij procedimi penal.

Nga ana subjektive, kjo vepër penale është kryer nga të pandehurit ***, *** dhe *** me dashje direkte. Subjekti i kësaj figure vepre penale janë të pandehurit ***, *** dhe ***, për të cilët rezultojnë të kenë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe nuk verifikohet prania e ndonjë shkakut që t'i privojë nga përgjegjësia penale, pra janë të përgjegjshëm para ligjit penal.

Fajësia e të pandehurve në kryerjen e kësaj vepre penale rezultoi e provuar nga të gjitha provat e sipërcituara të paraqitura nga përfaqësuesi i akuzës, të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore. Gjykata, krijoi bindjen se të pandehurit ***, *** dhe ***, janë subjekti i kryerjes së veprës penale "Shkelja e të drejtave të Pronësisë industriale", kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 149/a/2 të Kodit Penal pasi, me veprimet e tyre të kundërligjshme ka shkelur përcaktimet e dispozitës penale të sipërcituar, ngarkohen me përgjegjësi penale dhe duhet të përgjigjen penalisht sipas sanksioneve të kësaj dispozite të Kodit Penal.

Në lidhje me akuzën për veprën penale "Fshehja e të ardhurave", të parashikuar nga neni 180/1 Kodi Penal, ndaj të pandehurve ***, *** dhe ***, Gjykata vlerëson se ata duhet të deklarohen të pafajshëm. Lidhur me këtë fakt neni 180 i K.Penal, përcakton se:

"Fshehja apo shmangia nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet".

Sikurse ka parashikuar kjo dispozitë kërkohet që subjekti të veprojë në një mënyrë të caktuar për tu konsideruar se ka konsumuar këtë vepër penale. Për më tepër, Gjykata vlerëson se subjekt i kësaj vepre penale nuk mund të jetë çdo person, por vetëm ato subjekte që veprojnë si persona fizik apo juridik në veprimtari ekonomike apo tregtare, sipas legjislacionit tatimor dhe që janë rregjistruar si të tillë. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se do të konsiderohen si subjekte të veprës penale "Fshehja e të ardhurave", të parashikuar nga neni 180/1 Kodi Penal, vetëm ato subjekte, persona fizik ose juridik, të cilët janë subjekte tatimor dhe që veprojnë në një nga mënyrat që parashikon neni 180 i K.Penal, e qëllim fitimin material.

Nga aktet e administruara nuk rezultoi që ndonjë prej të pandehurve të ketë kryer veprimtari ekonomike si subjekt i të drejtës tregtare dhe të ketë fshehur të ardhurat qëllimisht, në ndonjë nga format e parashikuara nga neni 180 i K.Penal.

Referuar, analizës juridike si më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të bindjes së saj të krijuar mbi provat e administruara në gjykim, të pandehurit ***, *** dhe ***, Gjykata

duhet të deklarohen të pafajshëm për veprën “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180/1 Kodi Penal.

Ndërkohë lidhur me veprën penale “Shkelje e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal, fajësia e të pandehurve ***, ***, dhe *** rezulton e provuar dhe duhet të deklarohen fajtor për këtë veprë penale.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurit ***, *** dhe ***, Gjykata bazuar në nenet 47, 48/ç e 49 të K.Penal, ka detyrimin ligjor të marrë në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurve, shkallën e fajësisë në kryerjen e veprës penale (dashje direkte), qëndrimin pohues e pendues të të pandehurve për veprën penale të kryer si dhe rrethanat sociale, familjare, e kushtet ekonomike të të pandehurve.

Gjithsesi, në një vlerësim të hollësishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga të pandehurit, Gjykata konkludoi se lloji dhe masa e dënimit me burgim për të pandehurit ***, ***, dhe ***, e kërkuar nga organi i akuzës është në raport të drejtë me vlerësimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale e në veçanti dhe me rrethanat lehtësuese dhe rënduese të pranishme në këtë rast, të cituara më sipër.

Kështu, lidhur me masën e dënimit me burgim që duhet të caktohet ndaj të pandehurve, në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuar prej saj, dhënia e masës së dënimit me burgim çmohet nga Gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të të pandehurve në të ardhmen në shoqëri, ku e shikon të përshtatshme dhe me vend zbatimin e nenit 63 të K.Penal.

Gjykata çmon se për shkak të rrezikshmërisë së pakët që paraqesin të pandehurit, plotësohen kriteret ligjore për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe detyrimin e të pandehurit për kryerjen e një pune në interes publik, të parashikuar në nenin 63 të K.Penal, i cili sanksionon:

“Gjykata, për shkak të rrezikshmerisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Në vendimin e saj Gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbaje kontakte me Shërbimin e Provës. Shërbimi i Provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e

provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën. Gjykata, në këtë rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi”.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë e autorit të veprës penale përfshihet në kategorinë e alternativave të dënimit me burgim dhe synon të zgjerojë mundësitë e edukimit dhe rehabilitimit në shoqëri të personit që ka kryer veprën penale në forma të ndryshme nga ajo e kufizimit të lirisë së tij personale. Në rastin konkret, Gjykata çmon se riedukimi i të pandehurit mund të realizohet pa qënë e nevojshme që ajo të izolohet nga shoqëria.

Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore ato duhet t’i ngarkohen të pandehurit, pasi atij i referohet dënimi në zbatim të nenit 393 të K.Pr.Penale.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në seancë dhe provat shkresore të ndodhura në dosje pjesë përbërëse e fashikullit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Në vështrim të neneve 379, 384, 388, 390, 406 të K.Pr.Penale dhe neneve 180/1 e 63 të Kodit Penal, Gjykata:

VENDOSI:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit ***, për veprën vepre penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal dhe dënimin e tij, me *** muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin *** me *** muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 63 të K.Penal, pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin e të pandehurit *** për të kryer *** orë pune në interes publik, brenda një kohe prej *** muajsh dhe gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës, Tiranë.
- Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë.
- Në bazë të nenit 388/d të K.Pr.Penal, deklarin e pafajshëm të të pandehurit *** për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180/1 Kodit Penal.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit ***, për veprën vepre penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal dhe dënimin e tij, me *** muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin *** me *** muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 63 të K.Penal, pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin e të pandehurit *** për të kryer *** orë pune në interes publik, brenda një kohe prej *** muajsh dhe gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës, Tiranë.

- Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë.
- Në bazë të nenit 388/d të K.Pr.Penal, deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180/1 Kodi Penal.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit ***, për veprën penale “Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”, të parashikuar nga neni 149/a/2 i K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënimin e tij, me *** muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, masës së mësipërme të dënimit i zbritet 1/3, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin *** me *** muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 63 të K.Penal, pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin e të pandehurit *** për të kryer *** orë pune në interes publik, brenda një kohe prej *** muajsh dhe gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte me Zyrën e Shërbimit të Provës, Tiranë.
- Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë.
- Në bazë të nenit 388/d të K.Pr.Penal, deklarimin e pafajshëm të të pandehurit *** për veprën penale “Fshehja e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180/1 Kodi Penal.
- Shpenzimet proceduriale të fazës së hetimit paraprak, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes së tij.
- U shpall sot në Tiranë, më datë 26.05.2021.

Sekretare

Gjyqtar

**Besarda
Sokol PASHO**

ALLARAJ

**Shpenzime te prokurorise
Total 2000 leke
Shpenzimet gjyqesore s/paraprake
Njoftime 150 leke
Shpenzime gjyqesore ne themel
Njoftime 6x150 leke**